VENDIM
Nr. 15, datë 7.2.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të neneve 124 dhe 125, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", miratuar me vendimin nr. 59, datë 29.8.2008, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 5, pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

"3/1. Në rastin kur klienti aplikon për një kredi në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat dhe kur banka vlerëson se kapacitetet e tij për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit janë të pamjaftueshme, banka i ofron klientit, si alternativë, një kredi të krahasueshme në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat e tij.";

b) Në nenin 7, pika 2, shkronja d), pas togfjalëshit "një koment të shkruar", shtohet togfjalëshi "të shoqëruar me një shembull ilustrues,".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko